



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:040218
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05644393

KPPP.nr.628/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina", SH.A. me seli në rrugën "Hazir Shala", nr.4 - Prishtinë, kundër debitorit Agjensionit Turistik "Zogu" me seli në rrugën "Edith Durham" Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.24/21 të datës 04.02.2021, të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Agjensionit Turistik "Zogu", ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.24/21 i datës 04.02.2021, të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina", SH.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.24/21 të datës 04.02.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr.1569, nga data 01.01.2013 deri me datë 30.01.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,013.42 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, në të kundërtën përmbartimi të realizohet me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në xhirollogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e kreditorit në TEB Bank nr...., ndërsa nëse debitori nuk ka mjete në llogarinë e tij përmbartimi të realizohet me konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajshme të debitorit deri në vlerën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbartimit për shkak të parashkrimit dhe për faktin se propozimi nuk përmban asnjë dokument të besueshëm në bazë të së cilit është lejuar përmbartimi. Andaj i propozon Gjykatës ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj urdhrin përmbartimor si të pabazuar.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ndër të tjerash ka theksuar se e kundërshton prapësimin si të pa bazuar dhe pa mbështetje në prova. Ka shtuar se e kundërshton pretendimin lidhur me parashkrimin pasi që debitori ka pranuar borxhin e tij dhe ka kryer pagesa të pjesshme. Andaj i propozon Gjykatës që ta refuzoj prapësimin si të pabazuar si dhe të obligohet debitori që ta kryej obligimin e tij.

Gjykata në ri procedurë duke i pasur parasysh sugjerime dhe vërejtje të Dhomës së Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate sipas aktvendimit me numër K.DH.Shk II.nr.1198/23 të datës 18.03.2024, e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr.1569, Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartim, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit dhe nuk është përfshirë periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit.

Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që ekstrakti nr. Nr.1569 përfshin periudhën kohore deri më datë 31.12.2013 në shumë prej 801.79 EUR, ndërsa në përmbajtjen e ekstraktit, janë të listuara faturat vetëm nga data 31.12.2013 e tutje, ashtu vlera e borxhit prej 801.79 EUR e paraqitur si saldo, nuk dihet se për cilën periudhë kohore është grumbulluar dhe a është njoftuar debitori lidhur me këtë detyrim.

Prandaj, në formën e paraqitur, ekstrakti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe rrjedhimisht nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Meqenëse gjykata gjeti se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve të tjera të ngritura nga debitori si në prapësim, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit vendosi jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.628/24 datë 30.04.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.